



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:175629

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05646420

KPPP.nr. 1296/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Gazeta Shmeta” Sh.P.K., me numër biznesi 810873754, me seli në Prishtinë, rr. “Vicianum” p.nr, kundër debitorit “Kosovo Endocrine Group” Sh.P.K., me numër biznesi 811475723 dhe seli në Ferizaj, fshati Talinoc i Jerlive, p.nr., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 450/23, i lejuar me datë 24.07.2023, nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 02.05.2024, merr këtë:

A S K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Kosovo Endocrine Group” Sh.P.K., me numër biznesi 811475723, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 450/23, i lejuar me datë 24.07.2023, nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme - Faturës nr. 57/2021, e datës 01.11.2021; Faturës nr. 65/2021, e datës 01.12.2021; Faturës nr. 73/2021, e datës 31.12.2021; Faturës nr. 06/2022, e datës 31.01.2022; Faturës nr. 13/2022, e datës 01.03.2022; Faturës nr. 19/2022, e datës 31.03.2022; Faturës nr. 25/2022, e datës 30.04.2022, si dhe; Faturës nr. 30/2022, e datës 01.06.2022, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 450/23, të datës 24.07.2023, me të cilin është detyruar debitori, që në emër të faturave, kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 3,600.00, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se faturat nuk janë të nënshkruara dhe të pranuar në rregull nga

debitori. Tutje, ka theksuar se e gjithë mosmarrveshja ka ndodhur në mirëbesimin e debitorit ndaj kreditorit, ku i njëjti nuk ka treguar se çfare shërbimesh ka faturuar dhe ka kryer për debitorin ku ka qenë i obliguar nga kontrata. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ashtu që urdhri përmbarrimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit janë pa bazë ligjore, ndërsa ka shtuar se faturat i janë dërguar në mënyrë të rregullt debitorit, ku kreditori disa herë i është drejtuar debitorit me kërkesa për realizimin e pagesave, shtyrja e afatit për realizimin e pagesave është bërë me kërkesë të debitorit dhe në mirëbesim nga kreditori. Tutje, ka shtuar se të gjitha shërbimet janë realizuar sipas kontratës për të cilat debitori asnjëherë nuk ka bërë ankesë për mungesë të shërbimeve, dhe as nuk ka kërkuar të shkëputet kontrata. Më tej, ka theksuar se për këto shërbime kreditori ka pranuar vetëm dy pagesa të faturave, një të cash dhe tjetrën përmes bankës, të cilat pagesa janë minusuar nga kreditori për qëllime të mirëbesimit. Prandaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarrimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së: *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, pika 1.3 e njëjtit nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet, përkatësisht faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarrimor, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se faturat në fjalë janë dorëzuar

në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se e njëjta është pranuar nga debitori, për arsye se faturave i'u mungon nënshkrimi apo vula e pranimit të debitorit. Ndërsa, në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmoj se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit, ndërsa ky i fundit ka pranuar faturat në fjalë dhe se është pajtuar me përmbajtjen dhe lartësinë e të njëjtës. Rrjedhimisht, faturat si të tilla rezultojnë të jenë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, andaj edhe nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm.

Gjykata ka vlerësuar edhe komunikimet elektronike të bashkangjitura në propozim për përmbarim përmes së cilave kreditori ka pretenduar se faturat i janë dorëzuar debitorit, mirëpo gjë që dorëzimi i faturave në adresën elektronike të debitorit, nuk mund të konsiderohet dorëzim i rregullt përderisa sa kreditori nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi se faturat janë pranuar nga debitori, përkatësisht se i njëjti ka konfirmuar pranimin e email-it me përmbajtjen e faturave mbi bazën e së cilës është iniciuar procedura përmbarimore.

Andaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71, pika 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1296/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.